



Plannar / Doretuar Punëjeto/Prodato Received/Delivered		07.12.2021		viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SPN/HC	5848/2021		1/3	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.893/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.893/2021 të datës 29.10.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga "Tahir Zemaj", Nr.2 në Fushë Kosovë, kundër organit të punësimit/Komuna e Fushë Kosovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 06.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.893/2021 e datës 29.10.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën e punës Zyrtar Ligjor 2, pranë Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Fushë Kosovës, me datë 29.10.2021, ka parashtruar ankesën me numër protokollit 5206/2021 të regjistruar me numër A.nr.893/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se e njëjta në cilësinë e Zyrtares Ligjore në Komuna e Fushë Kosovës, në kundërshtim me përkrahimin e detyrave të punës obligohet nga organi punëdhënës që t'i kryej procedurat e rekrutimit për zyrtarët publik të Komunës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 02.11.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Komuna e Fushë Kosovës. Këshilli më datë 11.11.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5206/2021 të regjistruar me numër A.nr.893/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e datës 12.09.2019 për pozitën Zyrtar Ligjor 2; Akt Emërimit të datës 29.11.2019 për ankuesen; Ndryshimin dhe plotësimin e Aktit të Emërimit për ankuesen, të datës 30.11.2020; Letërnjoftimin e ankueses; Zarfën e datës 27.10.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 02.11.2021; Përgjigjen në ankesë të datës 11.11.2021; Shkresën për detyrat kryesore të punës për pozitën Zyrtar Ligjor 2.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e palejuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës 30.11.2020 është e punësuar në pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 2" në Drejtorinë e Arsimit pranë Komunës së Fushë Kosovës.

E njëjta në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se organi i punësimit, në kundërshtim me përshkrimin e detyrave të punës e obligon të njëjtën për kryerjen e procedurave të rekrutimit për zyrtarët publik të Komunës së Fushë Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke iu referuar nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 125 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton se një nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e tij e punës.

Kolegji, mbi këtë bazë ligjore, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë, dhe gjatë administrimit të provave nuk ka gjetur ndonjë akt administrativ apo veprim tjetër të organit të punësimit përmes të cilit ankuesja është caktuar si person përgjegjës për zhvillimin e procedurave të rekrutimit siç pretendon e njëjta.

Andaj, duke marr parasysh se parashtruesja e ankesës nuk ka bashkangjitur ndonjë provë e cila do të vërtetonte faktin e ngritur se organi i punësimit përmes ndonjë veprimi apo mosveprimi ka cenuar të drejtat e saj nga marrëdhënia e punës, Kolegji vlerëson se ankesa A.nr.893/2021 e datës 29.10.2021 e parashtruar nga ankuesja **nuk është e pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.**

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.893/2021

Avdyll BEKTESHI,


Procesmbajtës



Jeton KOÇA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Fushë Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

